

LegalNews

Nëntor 2018
November 2018



I. Ndryshime ne rregulloren e ERE për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike

Bordi i Entit Rregullator të Energjisë ("ERE") miratoi më datë 02.11.2018, vendimin nr. 239 'Mbi rishikimin e "Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike" ("Vendimi"). Vendimi është botuar në Fletoren Zyrtare numër 164, datë 16.11.2018 dhe hyn ne fuqi menjëherë me botimin e kësaj fletoreje.

Në Vendim parashikohet shtimi i kategorisë "Tregu i organizuar i energjisë elektrike (Bursa Shqiptare e Energjisë)", në zbatim të pikës 3.5 të vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 519, datë 13.07.2016, "Për miratimin e modelit të tregut të energjisë elektrike". Bursa Shqiptare e Energjisë është shtuar gjithashtu tek tipat e mundshme të licencave nën formatin dhe dokumentacionin për aplikim.

Më tej, Vendimi përcakton se për sa kohë është e lejuar nga legjislacioni në fuqi i Republikës së Shqipërisë, nuk do të kërkohet licencë për tregtimin e energjisë elektrike ose furnizimin me energji elektrike, në rast se një shoqëri ka një licencë të lëshuar nga një autoritet rregullator i një vendi tjetër me të cilin është nënshkruar një marrëveshje dypalëshe, për njohjen reciproke të licencave ndërmjet ERE-s dhe autoritetit përkatës rregullator.

I. Amendments to the Regulation of ERE on the granting, modification, transfer, renewal or termination of licenses in the electrical power sector.

The Board of Energy Regulator Entity (ERE) has approved, on 02.11.2018, the decision no. 239 on 'On reviewing of "The Regulation on the procedure and terms for license issue, modification, transferring, renewal or license termination in the electrical power sector" ("Decision"). The Decision has been published in the Official Gazette no.164, dated 16.11.2018 and will be effective immediately upon the gazette's publication.

The Decision prescribes the addition of the category "Organized electricity market (Albanian Power Exchange)", pursuant to point 3.5 of the Decision of Council of Ministers no. 519, dated 13.07.2016 "On approval of the electricity market model". The Albanian Power Exchange has also been added on the potential types of licenses under the forms and documentation for application.

Furthermore, the Decision specifies that, insofar as permitted by the applicable legislation of the Republic of Albania, a license for the trading or supplying of electricity will not be required, in instances where a company has a license issued by a regulating authority of another country with which a bilateral agreement has been signed, on the reciprocal recognition of licenses between ERE and the respective regulating authority.

Për sa i përket kohëzgjatjes dhe vlefshmërisë së licencave, parashikohet se për aplikimet në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike, të cilat paraqiten në ERE më vonë se data efektive e kontratës, llogaritja e afatit të licencimit bëhet për periudhën e mbetur. I njëjti rregull vlen edhe për rastet e modifikimit të licencave.

Dokumentacioni i kërkuar për kryerjen e aplikimit për pajisjen me licencë duhet të jetë në gjuhën shqipe dhe të depozitohet pranë ERE në origjinal ose kopje të noterizuar si dhe një kopje elektronike e të gjithë dokumentacionit të nevojshëm. Ndër të tjera parashikohet se aplikuesi duhet të paraqesë gjithashtu bashkëlidhur dokumenteve të aplikimit, vërtetimin e pagesës së aplikimit. Moskryerja e kësaj pagese përbën shkak për mospranimin e aplikimit nga ana e ERE.

Në lidhje me dokumentacionin teknik për veprimtarinë e furnizimit të energjisë elektrike, Vendimi përcakton se është i nevojshëm dokumentacioni që vërteton aftësinë e disponimit të zyrave përfaqësuese të furnizuesit, për shërbimet që do t'u ofrohen klientëve.

Për sa i përket procedurës së heqjes së licencës, Vendimi specifikon se fillimi i procedurës së heqjes së licencës nga ERE, përveç rasteve kur ndodh me iniciativë të kësaj të fundit, personave të interesuar apo mbajtësit e licencës, mund të bëhet edhe në zbatim të një vendimi gjykatë.

With regard to the duration and validity of the licenses, the Decision provides that for the applications on electricity production activity, which are presented to ERE after the effective date of the contract, the calculation of the license's deadline is made for the remaining period. The same rule applies to the modification of existing licenses.

The required documentation for the completion of the application for the provision of a license must be in the Albanian language and submitted to ERE as an original or as a copy certified by notarial deed, as well as an electronic copy of all the necessary documentation. Additionally, the applicant must also provide the proof of application payment attached to the application documentation. Failure to perform this payment constitutes a reason for refusal of the application by ERE.

As regards technical documentation on the activity of supply of electricity, the Decision specifies that is necessary the documentation that which confirms the ability of the supplier's representative office to provide services that will be provided to the customers.

With respect to license revocation, the Decision specifies that the initiation of the license revocation procedure by ERE, except for instances where the procedure starts with the latter's initiative, interested parties or license holders, can also be done by executing a court decision.

II. Ndryshime në Ligjin për Mbrojtjen e Konsumatorëve

Më datë 18.10.2018, Kuvendi i Republikës së Shqipërisë miratoi Ligjin nr. 71/2018 "Për disa ndryshime dhe shtesa në Ligjin nr. 9902, datë 17.04.2008, "Për mbrojtjen e konsumatorëve", të ndryshuar" ("Ligji"). Ligji është publikuar ne Fletoren Zyrtare nr. 162, datë 15.11.2018 dhe ka hyrë në fuqi 15 ditë pas botimit.

Ligji është përafuar pjesërisht me Direktivën 2011/83/BE të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit, datë 25.10.2011, "Mbi të drejtat e konsumatorit" dhe Direktivën 2013/11/BE të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit, datë 21.05.2013 "Për zgjidhjen alternative të mosmarrëveshjeve të konsumatorëve".

Ligji parashikon një sërë risish si zgjidhja alternative të mosmarrëveshjeve (ZAM), struktura ZAM, lloje te reja kontratash, etj., ndryshime për sa i përket të drejtave te konsumatorit dhe detyrimeve te tregtarit, apo risitë në lidhje me rastet që përbëjnë kundërvajtje administrative dhe sanksionet përkatëse.

Në kuadër të risive te Ligjit, uji, gazi dhe energjia konsiderohen si mallra në kuptim të legjislacionit për mbrojtjen e konsumatorit, kur vendosen në shitje në vëllim apo sasi të kufizuar.

Ligji përcakton kontratat të cilat përjashtohen nga fusha e zbatimit të tij, të tilla si kontratat për shërbime sociale, kujdesin shëndetësor, lojërat e fatit, shërbimet financiare, për krijimin, fitimin ose transferimin e pronësisë ose të të drejtave mbi sendet e paluajtshme, etj.

II. Amendments to Law on Consumer Protection

On 18.10.2018, the Albanian Parliament approved the Law no. 71/2018 "On some additions and amendments to Law no. 9902, dated 17.04.2008, "On consumer protection", as amended", ("Law"). The Law was published with the Official Gazette no. 162, dated 15.11.2018 and has entered into force 15 days after the publication.

The Law is partially approximated with Directive 2011/83/EU of the European Parliament and of the Council, dated on 25.10.2011, "On the consumer rights" and Directive 2013/11/EU of the European Parliament and of the Council, dated 21.05.2013 "On alternative dispute resolution for consumer disputes".

The Law provides for several novelties, such as the alternative dispute resolution (ADR), ADR's structure, new types of contracts, etc., amendments related to the consumer rights and seller's obligations, or novelties with regard to the cases constituting an administrative offense and the relevant penalties.

In the ambit of the novelties brought by the Law, water, gas and energy are considered goods in the meaning of the legislation on consumer protection, when are offered for sale in limited quantities and volume.

The Law determines the contracts which are excluded from the scope of its operation such as contracts for social services, health care, gambling, financial services, creation, acquisition or transfer of ownership title or rights over the immovable properties, etc.

Ligji përcakton krijimin e strukturës përgjegjëse për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve përmes procedurës të zgjidhjes alternative të mosmarrëveshjeve (Struktura ZAM), si dhe kërkesat e përgjithshme për ushtrimin e funksioneve të Strukturës ZAM, trajtimi i mosmarrëveshjeve përfshirë parashikimin e të drejtave dhe detyrimeve të palëve të përfshira.

Deri në krijimin e strukturës përgjegjëse për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve të tjera nga ato që lidhen me shërbimet me interes publik, funksionet e saj do të kryhen nga Komisioni i Mbrojtjes së Konsumatorëve, ndërsa strukturat përgjegjëse ZAM mbi shërbimet me interes publik fillojnë të ushtrojnë funksionet e parashikuara në këtë Ligj, 6 muaj pas hyrjes në fuqi të tij.

Për sa i përket strukturave ZAM të shërbimeve me interes publik, për veprimtaritë në fushën e energjisë elektrike dhe të gazit natyror funksionet e ZAM kryhen nga Enti Rregullator i Energjisë. Në fushën e komunikimeve elektronike dhe shërbimet postare, funksionet kryhen nga Autoriteti i Komunikimeve Elektronike dhe Postare. Funksionet e ZAM për veprimtarinë në fushën e furnizimit me ujë dhe përpunimit të ujerave të ndotura kryhen nga Enti Rregullator i Ujerave. Për veprimtaritë në fushën e sigurimit dhe risigurimit, funksionet e ZAM kryhen nga Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare, si dhe për veprimtaritë në fushën e aviacionit civil, kryhen nga Autoriteti i Aviacionit Civil.

The Law provides for the establishment of the structure responsible for disputes resolution through the procedure of alternative disputes resolution (ADR structure), as well as the general requirements for exerting of the ADR structure functions management of the disputes including the rights and obligations of the involved parties.

Until the establishment of the structure responsible for resolving the disputes other from those related to services with public interest, its functions will be carried out from the Commission on Consumer Protection, whereas the ADR structures responsible for public interest services start to exercise their activities as provided in this Law, 6 months after its entrance into force.

With regard to ADR structures for public interest services, for activities in the field of electricity and natural gas the ADR are carried out by Energy Regulatory Entity. For activities in the field of electronic communications and postal services, the ADR functions are carried out by the Electronic and Postal Communications Authority. ADR's functions in the field of water supply and wastewater treatment are carried out by the Water Regulatory Entity. As for the activities in the field of insurance and reinsurance, the ADR functions are carried out by the Financial Supervisory Authority, as well as for activities in the field of civil aviation, the ADR functions are carried out by the Civil Aviation Authority.

Veprimtaria e strukturave ZAM do të mbikëqyret nga Komisioni i Mbrojtjes së Konsumatorëve.

Në vijim të këtyre ndryshimeve, parashikohet gjithashtu se Avokati i Popullit nuk do të jetë më një nga institucionet ku konsumatori mund të paraqesë ankesë për shkeljen e të drejtave të tij.

The activity of the ADR structures will be supervised by the Commission on Consumer Protection.

Following these amendments, it is also provided that the Ombudsman will no longer be one of the institutions where the consumer may submit a complaint for violation of its rights.

Deloitte Contacts

Olindo Shehu, CPA

Partner | Tax & Legal Services
Deloitte Albania sh.p.k

Rr. "Elbasanit", Pallati prane Fakultetit
Gjeologji Miniera
Tirana | Albania
Mob: +355 68 60 33 116
E-mail: oshehu@deloitteCE.com

Disclaimer:

This publication contains general information only, and none of Deloitte Touché Tohmatsu Limited, any of its member firms or any of the foregoing's affiliates (collectively the "Deloitte Network") are, by means of this publication, rendering accounting, business, financial, investment, legal, tax, or other professional advice or services.

This publication is not a substitute for such professional advice or services, nor should it be used as a basis for any decision or action that may affect your finances or your business. Before making any decision or taking any action that may affect your finances or your business, you should consult a qualified professional adviser. No entity in the Deloitte Network shall be responsible for any loss whatsoever sustained by any person who relies on this publication.

No entity in the Deloitte Network shall be responsible for any loss whatsoever sustained by any person who relies on this publication.

Deloitte refers to one or more of Deloitte Touché Tohmatsu Limited, a UK private company limited by guarantee, and its network of member firms, each of which is a legally separate and independent entity. Please see www.deloitte.com/al/about for a detailed description of the legal structure of Deloitte Touché Tohmatsu Limited and its member firms.

Deloitte provides audit, tax, consulting, and financial advisory services to public and private clients spanning multiple industries. With a globally connected network of member firms in more than 150 countries, Deloitte brings world-class capabilities and deep local expertise to help clients succeed wherever they operate. Deloitte's approximately 263,900 professionals are committed to becoming the standard of excellence.